

VENDIM
Nr. 150, datë 11.12.2015

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E “METODOLOGJISË SË
PËRCAKTIMIT TË TARIFËS FIKSE TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR
NGA CENTRALET ME PËRPARËSI QË SHFRYTËZOJNË BURIME TË
RINOVUESHME ENERGJIE”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 15, pika 1, të ligjit nr. 138/2013, “Për burimet e energjisë së rinovueshme”, dhe nenit 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.12.2015, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të saj, dhe draftin për metodologjinë e përcaktimit të tarifës fikse të energjisë elektrike të prodhuar nga centralet me përparësi që shfrytëzojnë burime të rinovueshme energjie”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të tarifës fikse të energjisë elektrike të prodhuar nga centralet me përparësi që shfrytëzojnë burime të rinovueshme energjie”.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve të interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti